



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

“PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE PËR ZBATIMIN E
GRUMBULLIMIT TË DIFERENCUAR TË MBETJEVE PËR TË GJITHA RRYMAT E
MBETJEVE”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 11 dhe pikës 5, të nenit 47, të ligjit nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Objekti i këtij vendimi është miratimi i kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve, me qëllim lehtësimin ose përmirësimin për përgatitjen për ripërdorim, riciklim dhe operacioneve të tjera të rikuperimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbetjet.
- Grumbullimi i diferencuar i rrymave të mbetjeve realizohet në mënyrë të tillë që të garantohet:
 - parandalimi i përzierjes së rrymave të mbetjeve, me qëllim ripërdorimin, riciklimin dhe operacionet e tjera të rikuperimit,
 - parandalimi i ndotjes së mjedisit dhe çdo ndikimi negativ në shëndetin e njeriut.
- Grumbullimi i diferencuar zbatohet nga subjektet e parashikuar në këtë vendim, duke respektuar parimin e hierarkisë së mbetjeve, ekonomisë qarkulluese, parimin “ndotësi paguan”, si dhe parimet e mbrojtjes, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

**II. KRITERET PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR PËR TË GJITHA RRYMAT
E MBETJEVE**

¹ Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

1. Grumbullimi i diferencuar i të gjitha rrymave e mbetjeve realizohet nga bashkia ose nga operatori i licencuar, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) mbetjet mbahen të ndara dhe nuk përzihen me mbetje të tjera, qofshin këto të rrezikshme apo jo të rrezikshme, si dhe as me substanca që mund të pengojnë rikuperimin ose trajtimin e tyre;

b) infrastruktura për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që sipërfaqet ose platformat mbështetëse të jenë të forta, rezistente dhe të papërshkueshme nga uji dhe lëngjet, me qëllim parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore;

c) pikat e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve:

i) vendosen në distancë jo më të vogël se 100 m nga burimet ujore dhe zonat e ndjeshme, të tilla si zonat e mbrojtura, zonat bregdetare, zonat e banuara dhe institucionet publike, me qëllim parandalimin e ndotjes së ujrave dhe mjedisit;

ii) vendosen në vende të arritshme, duke mundësuar hyrje dhe dalje për mjetet e transportit, si dhe hapësirë të mjaftueshme për vendosjen, përdorimin dhe zbrazjen e kontejnerëve;

iii) të jenë të pajisura me masa mbrojtëse si rrethim, mbulim ose struktura të ngjashme për të parandaluar shpërndarjen e mbetjeve në mjedis dhe ekspozimin e tyre ndaj shiut, erës dhe kushteve të tjera atmosferike;

iv) të jenë të ajrosura në mënyrë natyrale ose të pajisura me sisteme ventilimi, si dhe të pajisen me mjete për shuarjen e zjarrit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri.

ç) kontejnerët, enët, qeset, pajisjet e grumbullimit, si dhe çdo mjet tjetër i përshtatshëm për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve:

i) të jenë të mbyllura, ose të pajisura me kapakë, mbulesa ose mekanizma të tjerë mbyllës që parandalojnë daljen, shpërndarjen dhe rrjedhjen e mbetjeve;

ii) të jenë të ndërtuara me materiale rezistente ndaj dëmtimit, përfshirë korrozionin dhe goditjet gjatë përdorimit, si dhe në forma që mundësojnë pastrim dhe sipas rastit dezinfektim;

iii) të jenë të pajisura me etiketa të dukshme, të lexueshme dhe rezistente që identifikojnë llojin e mbetjeve që lejohen të depozitohen.

2. Përveç kriteve të parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, për secilën rrymë mbetjesh zbatohen kriteret specifike të përcaktuara më poshtë.

3. Për vajrat e përdorura, grumbullimi i diferencuar kryhet në mënyrë të tillë që të sigurohet:

1 Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3-30.

a) ndarja sipas kategorive në vajra lubrifikuese dhe nënkategoritë e saj, vajra minerale apo vajra sintetike, duke ndaluar përzierjen ndërmjet tyre dhe me substanca të tjera që ndikojnë në përbërjen dhe cilësinë e vajit

a) shmangien e kontaminimit me ujë, karburante, tretës ose papastërti të tjera;

b) depërtimi i ndotësve të jashtëm si lagështi, pluhur, substanca kimike, me qëllim ruajtjen e karakteristikave fiziko-kimike;

c) oksidimin, kontaktin me ajrin dhe faktorë të tjerë që shkaktojnë degradim, me qëllim ruajtjen e cilësisë për rigjenerim ose trajtim të mëtejshëm.

4. Për mbetjet bio, grumbullimi i diferencuar kryhet në mënyrë të tillë që të sigurohet:

a) ndarja e tyre nga rrymat e tjera të mbetjeve;

b) kontrolli i proceseve të dekompozimit;

c) minimizimi i lagështisë së tepërt;

ç) parandalimi i formimit të erërave dhe rrjedhjes së lëngjeve;

d) parandalimi i pranisë së insekteve dhe organizmave të tjerë dëmtues;

dh) ruajtja e përbërjes organike, me qëllim trajtimin e tyre përmes kompostimit ose proceseve të tjera biologjike, pa ndikuar në cilësinë e produktit përfundimtar.

5. Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

a) ndarjen sipas llojit të materialit;

b) parandalimin e kontaminimit me mbetje ushqimore, lëngje ose substanca të tjera që dëmtojnë cilësinë e materialit dhe pengojnë proceset e riciklimit;

c) ruajtjen e karakteristikave fizike të ambalazheve, duke shmangur deformimin, thyerjen dhe dëmtimet e tjera, që mund të vështirësojnë përpunimin dhe riciklimin e tyre.

6. Për produktet plastike njëpërdorimshme, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

a) ndarjen e tyre nga mbetjet e tjera, veçanërisht nga materialet jo plastike;

b) parandalimin e kontaminimit me mbetje të tjera që ndikojnë në cilësinë e materialit dhe pengojnë riciklimin;

c) parandalimin e shpërndarjes së tyre në mjedis për shkak të peshës së ulët dhe dimensioneve të vogla.

7. Për bateritë dhe mbetjet e tyre, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

a) ndarjen sipas llojit, përfshirë bateritë portative, industriale dhe ato të automjeteve;

b) parandalimin e dëmtimit fizik, rrjedhjen e elektroliteve dhe kontaktit ndërmjet poleve që mund të shkaktojnë qark të shkurtër;

1 Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3-30.

c) identifikimin dhe mbajtjen e veçuar të baterive të dëmtuara, të rrjedhura ose të deformatuara, në kushte që shmangin përhapjen e substancave të rrezikshme;

ç) shmangien e ekspozimit ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë, me qëllim ruajtjen e sigurisë dhe gjendjes fizike të tyre.

8. Për automjetet në fund të jetës, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

a) dorëzimin e tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara;

b) parandalimin e braktisjes së automjeteve dhe çmontimit të pakontrolluar të tyre;

c) mundësimin e çmontimit të kontrolluar të komponentëve dhe ndarjen e materialeve, përfshirë heqjen e baterive, sistemeve elektrike, airbag-eve, filtrave dhe pjesëve që përmbajnë substanca të rrezikshme;

ç) parandalimin e rrjedhjes së lëngjeve, përfshirë karburantet, vajrat, ftohësit dhe lëngjet e tjera teknike, si dhe heqjen e sigurt të tyre.

9. Për pajisjet elektrike dhe elektronike, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

a) ruajtjen e gjendjes funksionale dhe fizike të tyre;

b) shmangien e dëmtimit, fragmentimit ose çmontimit të pakontrolluar;

c) parandalimin e çlirimit të substancave të rrezikshme dhe përbërësve të tyre;

ç) identifikimin dhe mbajtjen në mënyrë të veçuar të pajisjeve ose komponentëve që përmbajnë elementë të ndjeshëm, si bateri, ekrane, kondensatorë dhe llampa, me qëllim mundësimin e trajtimit të veçantë të tyre.

10. Për mbetjet nga ndërtimi dhe shembja, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

a) ndarjen sipas llojit të materialit, si beton, tulla, gurë, metale dhe dru, me qëllim lehtësimin e ripërdorimit dhe riciklimit;

b) identifikimin dhe ndarjen e materialeve që përmbajnë substanca të rrezikshme ose përbërës që pengojnë riciklimin, si materialet me përmbajtje azbesti, bojërat ose izolimet e ndotura.

11. Për mbetjet nga anijet dhe ngarkesat e tyre, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

a) ndarjen sipas llojit dhe natyrës së mbetjeve;

b) parandalimin e përzierjes së mbetjeve që mund të çojë në ndotje të mjedisit ujor;

c) parandalimin e derdhjeve dhe shpërndarjes së mbetjeve në ujë gjatë shkarkimit dhe grumbullimit, përfshirë mbetjet e lëngshme, mbetjet e ngarkesave dhe mbetjet e tjera të gjeneruara nga aktivitetet e anijes;

ç) identifikimin dhe mbajtjen e veçuar të mbetjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme;

d) dorëzimin në pikat portuale të autorizuara, në kushte që mundësojnë trajtimin e sigurt dhe parandalojnë ndotjen e ujërave dhe mjedisit detar.

12. Për gomat e përdorura, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

- a) ndarjen e tyre nga rrymat e tjera të mbetjeve;
- b) parandalimin e depozitimit të pakontrolluar ose djegies së tyre;
- c) ruajtjen e gjendjes fizike të gomave, duke shmangur deformimin dhe dëmtimet që rrisin rrezikun nga zjarri dhe pengojnë trajtimin e mëtejshëm për ripërdorim, riciklim ose rikuperim.

13. Për rrymat e tjera të mbetjeve, që nuk janë ambalazhe, si letër, karton, qelq, metale, plastikë, tekstile dhe mbetje shtëpiake të përziera, zotëruesi i mbetjeve siguron:

- a) ndarjen e tyre në burim dhe grumbullimin e diferencuar të tyre në pikat e përcaktuara nga bashkia ose të ngritura nga operatori i licencuar, në përputhje me parashikimet e Shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij;
- b) parandalimin e përzierjes me mbetje ose substanca të tjera që dëmtojnë trajtimin e mëtejshëm dhe cilësinë e materialit për përpunim dhe riciklim;
- c) ruajtjen e cilësisë së tekstileve, duke shmangur lagështinë, ndotjen dhe dëmtimet që i bëjnë të papërshtatshme për ripërdorim ose riciklim;
- ç) që mbetjet shtëpiake të përziera të mos përmbajnë mbetje të rrezikshme ose rryma të tjera që duhet të grumbullohen veçmas.

14. Për mbetjet e vëllimshme, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

- a) shmangien e fragmentimit, dëmtimit ose çmontimit të pakontrolluar gjatë fazës së grumbullimit;
- b) ruajtjen e gjendjes fizike të tyre, me qëllim lehtësimin e ripërdorimit, riciklimit ose rikuperimit.

15. Për mbetjet e rrezikshme shtëpiake, grumbullimi i diferencuar kryhet duke siguruar:

- a) parandalimin e përzierjes me mbetjet e tjera;
- b) parandalimin e depozitimit në kanalizime, tokë ose ujëra sipërfaqësore apo çdo formë depozitimi e paautorizuar.

III. PROCEDURAT PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË MBETJEVE

1. Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organizohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në kreun II, duke siguruar funksionimin e një sistemi të strukturuar për marrjen, transportin dhe dorëzimin e mbetjeve për trajtim, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve.

1 Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

2. Bashkia planifikon dhe organizon shërbimin e grumbullimit të diferencuar, duke përcaktuar pikat e grumbullimit, zonat ku ofrohet shërbimi, mënyrën e grumbullimit, si dhe frekuencën dhe oraret e shërbimit, në varësi të karakteristikave të territorit dhe sasisë së gjenerimit të mbetjeve.

3. Zotëruesi i mbetjeve siguron depozitimin e mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, në përputhje me mënyrën e organizimit të sistemit të grumbullimit të diferencuar dhe pikat e përcaktuara nga bashkia, ose i dorëzojnë ato vetëm tek operatori i licencuar për trajtimin e mëtejshëm.

4. Në rastin kur bashkia nuk i realizon vetë proceset e trajtimit të rrymave të mbetjeve të depozituara në pikat e grumbullimit, të administruara prej tyre, kontraktin operatorin e licencuar për trajtimin e tyre, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve.

5. Bashkia organizon informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe bizneseve për funksionimin e sistemit të grumbullimit të diferencuar dhe mënyrën e përdorimit të tij, si dhe siguron monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të këtyre procedurave në territorin e tyre, përfshirë verifikimin e përputhshmërisë së shërbimit me kërkesat e këtij vendimi.

6. Për vajrat e përdorura, grumbullimi i diferencuar kryhet sipas procedurës si më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) siguron ndarjen në burim të vajrave të përdorur sipas kategorive, nga mbetjet e tjera;

ii) dorëzon vajrat e përdorur vetëm te operatori i licencuar për rigjenerim ose trajtim të kësaj rryme mbetje.

b) Operatori i licencuar:

i) kryen grumbullimin e vajrave të përdorura sipas kategorive përkatëse;

ii) siguron filtrimin paraprak për largimin e mbetjeve të ngurta dhe papastërtive, kur është e nevojshme, me qëllim ruajtjen e cilësisë së vajit për trajtim në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi;

iii) transporton vajrat e përdorura me mjete të mbyllura ose cisterna të posaçme, të ndara sipas kategorive dhe të pajisura me sisteme sigurie për parandalimin e rrjedhjeve dhe aksidenteve, duke u shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

7. Për mbetjet bio, grumbullimi i diferencuar organizohet kryhet sipas procedurës si më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) ndan në burim mbetjet bio nga mbetjet e tjera;

ii) depoziton mbetjet bio në sistemet e ngritura nga bashkia, sipas kalendarit të grumbullimit të hartuar nga bashkia, sipas përcaktimit në Shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij.

b) Bashkia siguron:

i) infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin e mbetjeve bio;

ii) dorëzon mbetjet bio te operatori i licencuar për trajtimin e tyre, në rast se nuk e realizon vetë trajtimin e këtyre mbetjeve.

c) Operatori i licencuar për trajtimin e mbetjeve bio:

i) grumbullon mbetjet bio, sipas kalendarit të hartuar nga bashkia, sipas përcaktimeve në Shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij;

ii) transporton mbetjet bio me mjete të përshtatshme, të mbyllura dhe të mirëmbajtura, për të garantuar ruajtjen e cilësisë së tyre, minimizimin e dekompozimit të pakontrolluar dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe rreziqeve për shëndetin publik dhe kryen trajtimin e mëtejshëm të tyre.

8. Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, grumbullimi i diferencuar, kryhet sipas procedurës si më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) përgatit ambalazhet për depozitim, duke siguruar largimin e plotë të çdo përmbajtje të mbetur brenda tyre, në mënyrë që ambalazhi të jetë i zbrazur dhe i përshtatshëm për trajtim të mëtejshëm dhe kur është e mundur, reduktimin e volumit përmes shtypjes ose palosjes;

ii) dorëzon të pastra, të thata dhe pa u përzier me rryma të tjera mbetjesh, për sa është e mundur, tek operatori i licencuar për përpunimin, riciklimin ose trajtimin e tyre, me qëllim ruajtjen e cilësisë së materialit për riciklim.

b) Operatori i licencuar:

i) merr në dorëzim ambalazhet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar për përpunimin, riciklimin ose trajtimin e tyre;

ii) kryen transportin e tyre duke siguruar ndarjen sipas materialeve dhe shmangien e përzierjes ose shpërndarjes në mjedis gjatë këtij procesi.

9. Për mbetjet e produkteve plastike njëpërdorimëshe, grumbullimi i diferencuar kryhet sipas procedurës më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe, përfshirë konsumatorët, subjektet tregtare, njësitë e shërbimit ushqimor dhe organizatorët e aktiviteteve publike:

1 Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

i) grumbullon mbetjet e produkteve plastike njëpërdorimshe në mënyrë të diferencuar menjëherë pas përdorimit;

ii) dorëzon mbetjet e produkteve plastike njëpërdorimshe të pastra dhe pa u përzier me rryma të tjera mbetjesh, për sa është e mundur, tek operatori i licencuar për përpunimin, riciklimin ose trajtimin e tyre, me qëllim ruajtjen e cilësisë së materialit për riciklim;

b) Operatori i licencuar:

i) merr në dorëzim mbetjet e plastikës njëpërdorimshe në mënyrë të diferencuar për përpunimin, riciklimin ose trajtimin e tyre;

ii) kryen transportin e tyre me mjete të dedikuara, duke parandaluar përzjerjen me mbetje të tjera dhe shpërndarjen në mjedis gjatë këtij procesi.

10. Për bateritë dhe mbetjet e tyre, grumbullimi i diferencuar, kryhet sipas procedurës më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) grumbullon bateritë në mënyrë të diferencuar, duke i ndarë sipas llojit, të paktën në bateri portative, bateri industriale dhe bateri për automjete;

ii) depoziton këto mbetje në kontejnerë ose në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga bashkia ose të ngritura nga operatori i licencuar.

b) Bashkia ose operatori i licencuar:

i) kryhen transportin e mbetjeve të baterive në kontejnerë të mbyllur dhe të etiketuar, rezistentë ndaj korrozionit dhe të pajisur me masa sigurie kundër zjarrit, veçanërisht për bateritë me litium;

ii) bateritë ruhen përkohësisht në ambiente të ventiluara, të thata, me sipërfaqe të papërshkueshme dhe me masa për kontrollin e rrjedhjeve dhe parandalimin e zjarrit

iii) Në rastin kur bashkia nuk kryen vetë procedurën sipas shkronjës “b”, të kësaj pikë, kontraktin operatorin e licencuar për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, marrjes dhe transportit.

11. Për automjetet në fund të jetës, grumbullimi i diferencuar kryhet sipas procedurës si më poshtë:

a) Zotëruesi i automjetit:

i) siguron që automjeti të mos braktiset ose depozitohet në mënyrë të pakontrolluar në mjedis;

ii) dorëzon automjetin vetëm tek operatori i licencuar për grumbullimin ose trajtimin e tyre;

b) Operatori i licencuar:

i) organizon tërheqjen e automjetit nga vendndodhja, në rast se automjeti nuk është i lëvizshëm, duke përdorur mjete të përshtatshme për ngarkim dhe transport të sigurt, duke parandaluar rrjedhjet e lëngjeve dhe shpërndarjen e pjesëve gjatë transportit;

1 Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

ii) në momentin e pranimit, regjistron automjetin në pikën e grumbullimit, duke përfshirë të dhënat identifikuese si numri i shasisë, marka, modeli, viti i prodhimit dhe të dhënat e zotëruesit.

iii) depoziton automjetin në hapësira të posaçme, të pajisura me sipërfaqe të papërshkueshme nga lëngjet, si dhe të pajisura me sisteme për mbledhjen e rrjedhjeve të lëngjeve të automjetit;

iv) dërgon automjetet vetëm në impiante të licencuara, ku kryhet trajtimi i tyre, duke përfshirë pastrimin, heqjen e lëngjeve dhe komponentëve të rrezikshëm, si dhe çmontimin selektiv për ndarjen e pjesëve të ripërdorshme dhe materialeve të riciklueshme.

12. Për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike, grumbullimi i diferencuar kryhet sipas procedurës më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) grumbullon pajisjet elektrike dhe elektronike në mënyrë të diferencuar dhe i ruan në gjendjen ekzistuese, pa i çmontuar dhe pa i dëmtuar;

ii) dorëzon këto mbetje në kontejnerë ose pika të dedikuara grumbullimi, të përcaktuara nga bashkia, ose të ngritura nga operatori i licencuar;

b) Operatori i licencuar ofron shërbim të dedikuar për marrjen direkt të mbetjeve nga familjet dhe bizneset, në rast se nuk kryhet nga bashkia.

13. Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja kryhet si më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) ndan në burim mbetjet sipas llojit të materialit që në fazën e gjenerimit, duke shmangur përzierjen e mbetjeve të pastra ndërtimore;

ii) depoziton mbetjet në kontejnerë ose pika grumbullimi të vendosura në kantier;

iii) grumbullon mbetjet në mënyrë të sigurt brenda pronës së tyre, pa krijuar ndotje apo pengesa në hapësirat publike, në rast se kryejnë punime vetjake dhe i dorëzojnë në pika të dedikuara të përcaktuara nga bashkia, ose përmes shërbimit të ofruar nga operatori i licencuar.

b) Operatori i licencuar kryhen transportin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja me mjete të mbuluara dhe të përshtatshme, me qëllim shmangien e shpërndarjes së pluhurave dhe materialeve në mjedis.

14. Për mbetjet nga anijet dhe nga ngarkesat e tyre, grumbullimi i diferencuar kryhet sipas procedurës si më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) siguron vendosjen dhe organizimin e infrastrukturës së nevojshme për mbetjet e gjeneruara në bordin e anijes, me qëllim ndarjen në burim sipas llojit të mbetjeve në mjete të posaçme, sipas

1 Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

përcaktimeve në Shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij, pa u përzier me rryma të tjera mbetjesh;

ii) ruan mbetjet në bord në mënyrë të sigurt, deri në dorëzimin e tyre në port;

iii) njofton autoritetin portual ose operatorin e shërbimit përpara mbërritjes në port për llojin dhe sasinë e mbetjeve që do të dorëzohen

b) Autoriteti portual:

i) siguron vendosjen, organizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme si kontejnerë, pika grumbullimi dhe pajisje të tjera të dedikuara për grumbullimin e mbetjeve nga anijet dhe nga ngarkesat;

ii) dorëzon mbetjet te operatori i licencuar për trajtimin e tyre, në rast se nuk e kryen vetë.

c) Operatori i licencuar:

i) merr mbetjet nga anijet dhe nga ngarkesat, nga pikat e grumbullimit në port, ose kur është e nevojshme drejtpërdrejt nga bordi i anijes;

ii) siguron transportin e mbetjeve në mënyrë të sigurt dhe trajtimin e mëtejshëm të këtyre mbetjeve.

15. Për gomat e përdorura, grumbullimi i diferencuar kryhet sipas procedurës më poshtë:

a) Zotëruesi i gomave të përdorura, përfshirë gomisteritë, serviset e automjeteve, tregtarët dhe përdoruesit fundorë,

i) mbledh gomat menjëherë pas zëvendësimit të tyre, duke shmangur braktisjen në mjedis ose në hapësira publike;

ii) dorëzon mbetjet nga gomat e përdorura vetëm te operatori i licencuar;

b) Operatori i licencuar grumbullon dhe transporton mbetjet e gomave të përdorura në mënyrë të kontrolluar dhe të sigurt, në mënyrë që ruhet gjendja fizike e tyre, me qëllim mundësimin e riciklimit ose rikuperimit.

16. Për rrymat e tjera që nuk janë ambalazhe, si mbetjet e letrës, kartonit, qelqit, metaleve, plastikës, drurit, tekstileve dhe mbetjeve shtëpiake të përziera, grumbullimi i diferencuar kryhet sipas procedurës si më poshtë:

a) Zotëruesi i mbetjeve:

i) ndan mbetjet në burim në kontejnerë individualë;

ii) depoziton në kontejnerë publikë ose pika grumbullimi të dedikuara, të përcaktuara nga bashkia, të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në kreun II dhe identifikohen sipas ngjyrave të përcaktuara në Shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij;

1 Ky vendim është përafuar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

b) Zotëruesi i mbetjeve të vëllimshme grumbullon në pika të dedikuara të grumbullimit të përcaktuara nga bashkia ose i dorëzon përmes shërbimeve periodike të mbledhjes nga operatori i licencuar;

c) Mbetjet e rrezikshme shtëpiake grumbullohen në kosha individuale nga zotëruesi i mbetjeve dhe dorëzohen në kontejnerë ose pika të dedikuara të përcaktuara nga bashkia.

ç) Bashkia harton dhe përditëson, brenda datës 31 Janar të çdo viti, kalendarin e grumbullimit të diferencuar sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën 2, duke përfshirë llojin e mbetjeve, densitetin e popullsisë dhe kushtet infrastrukturore dhe teknike të zonës;

d) Në rast ndryshimesh në densitetin e popullsisë, kushtet infrastrukturore, volumin e mbetjeve të gjeneruara, përfshirë periudhat sezonale, ose në rast të problemeve operacionale që kërkojnë rishpërndarje të frekuencave të shërbimit, bashkia përditëson kalendarin e grumbullimit të përcaktuar në Shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij.

IV. AFATET PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR

1. Bashkia merr masat e nevojshme për përcaktimin dhe ngritjen e pikave të grumbullimit të diferencuar brenda vitit 2027.

2. Bashkia merr masat e nevojshme për zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim, për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve brenda afateve të përcaktuara si më poshtë:

a) për mbetjet e përziara brenda vitit 2028

b) për mbetjet tekstile brenda vitit 2028

c) për mbetjet e vëllimshme brenda vitit 2028

ç) për mbetjet nga ndërtimi dhe shembja brenda vitit 2028

d) për mbetjet nga anijet dhe nga ngarkesat brenda vitit 2028

dh) për mbetjet nga gomat e përdorura brenda vitit 2028

e) për mbetjet nga makinat në fund të jetës brenda vitit 2028

ë) për mbetjet nga vajrat e përdorura, brenda vitit 2028

f) për mbetjet letër, karton, qelq, metale, plastikë deri më 31.12.2030, të arrihen të paktën këto nivele minimale të riciklimit:

i. 50% plastikë;

ii. 70% metale;

iii. 70% qelq;

1 Ky vendim është përafshuar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

- iv. 75% letër/karton;
- g) Për mbetjet letër, karton, qelq, metale, plastikë më 31.12. 2035, të arrihen këto nivele minimale riciklimi sipas rrymave:
 - i. 55% plastikë;
 - ii. 80% metale;
 - iii. 75% qelq;
 - iv. 85% letër/ karton
- gj) deri më 31.12. 2030, minimumi 65% të peshës së të gjitha mbetjeve të ambalazheve të riciklohet
- h) deri më 31.12. 2035, minimumi 70% të peshës së mbetjeve të ambalazheve të riciklohet;
- i) deri më 31.12.2027, të grumbullohet minimumi 63% të mbetjeve nga bateritë dhe deri më 31.12.2030, të grumbullohet minimumi 73% të mbetjeve nga bateritë
- j) deri më datë 31.12.2027, të grumbullohen minimumi 45% të mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

V. DISPOZITAT E FUNDIT

Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, bashkitë, autoritetet portuale, zotëruesit e mbetjeve dhe operatorët e licencuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

Edi RAMA

1 Ky vendim është përafuar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.